

Numri i lëndës: 2024:036471

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05495962

C.nr.718/2024

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA V., gjyqtari Alush Sinani, me bashkëpunëtoren profesionale Dardana Behluli, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.T.nga fshati G., Komuna V., i përfaqësuar nga M.H., avokate në V., kundër të paditurës Komuna V.-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i pagës bazë sipas inflacionit, vlera e kontestit 576.02 €, jashtë seancës, me datë 22.03.2024, mori këtë:

AKTGJYKIM

I. Aprovohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadija e paditësit H.T.nga fshati G., Komuna V. dhe detyrohet e paditura Komuna e V.së-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditësit, në emër të pagesës shtesë në bazë të inflacionit, t'ia paguajë: për periudhën shkurt-dhjetor 2021, shumën 99.55 € dhe për periudhën janar-nëntor 2022, shumën 339.67 €, në shumën e përgjithshme 439.22 €, me kamatë ligjore 8%, e llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. Refuzohet pjesërisht pjesa tjetër e kërkesëpadiës në emër të inflacionit, e kërkuar për periudhën janar-dhjetor 2018, në shumën 35.13 €, janar-dhjetor 2019, në shumën 86.24 €, janar-dhjetor 2020, në shumën 6.38 € dhe muaji janar i V.t 2021, në shumën 9.05 €, në shumën të përgjithshme 136.80 €.

III. Detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë 99 €, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

Arsyetim

Paditësi, përmes të autorizuarit të saj, me datë 29.01.2024, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi nga marrëdhënia e punës në bazë të inflacionit, vlera e kontestit 576.02 €.

Në padi, paditësi ka theksuar se është në marrëdhënie pune tek e paditura, në shkollën "Mirali Sejdiu", në fshatin Goshicë, Komuna V. dhe nga gjykata ka kërkuar që e paditura, në emër të pagesës shtesë në bazë të përqindjes së inflacionit, për periudhën janar-dhjetor 2018, t'ia paguajë shumën 35.13 €; për periudhën janar-dhjetor 2019, t'ia paguajë shumën 86.24 €; për

periudhën janar-dhjetor 2020, t'ia paguajë shumën 6.38 €; për periudhën janar-dhjetor 2021, t'ia paguajë shumën 108.60 € dhe për periudhën janar-nëntor 2022, shumën 339.67 €, në shumën e përgjithshme 576.02 €. Të drejtën e saj e ka bazuar në nenin 35, paragrafi 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje KKAK) të V.t 14.04.2017 dhe 22.01.2021. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë shumën prej 104 € për përpilimin e padisë dhe 21 € për taksën gjyqësore për padi.

E paditura, përmes përgjigjjes në padi e ka kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, me pretendimin se kërkesa nuk është e bazuar në ligj, pasi që obligimet e parapara në KKAK duhet të paguhen nga niveli qendror, Ministritë përkatëse dhe anën tjetër, ka theksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit e kanë shkëputur këtë kontratë andaj rrjedhimisht edhe nuk mund të prodhojë obligim ligjor për të paditurën. Gjithashtu, e paditura është thirrur edhe në parashkrim të kërkesës së paditësit ashtu që, gjykatës i ka propozuar të refuzojë kërkesëpadinë e paditësit të pa bazuar në ligj. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Pas pranimit të përgjigjjes në padi, gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës gjyqësore, duke u mbështetur në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK), me të cilin përcaktohet se: "Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigjja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë", ka ardhur në përfundim se të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara në këtë nen janë plotësuar sepse, gjendja faktike nuk është kontestuese e po ashtu nuk ekzistojnë pengesa të tjera që pa caktuar seancë gjyqësore të pranohet si e themeltë kërkesëpadia e paditësit si dhe nenin 399.1 që përcakton se: "Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigjja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pa themeltë kërkesëpadia".

Nga përgjigjja e të paditurës në padi, gjykata ka gjetur se ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditësi është e punësuar tek e paditura, se pagën bazë e ka 266.20 € (fakt i provuar edhe nga lista e pagës në emër të paditësit EM00119684) ndërsa se shkalla e inflacionit për V.n 2021 është 3.4 % dhe për V.n 2022 është 11.6 % (fakt i provuar nga llogaritja e shkallës mesatare të inflacionit nga Enti i Statistikave të Kosovës).

Gjykata, duke u mbështetur në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje meritorë në këtë çështje juridike kontestimore, pasi provat materiale janë lëshuar nga organi shtetëror-lista e pagave nga ministria përkatëse dhe prova lidhur me

shkallën e inflacionit nga Agjencia e Statistikave të Kosovë, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Pasi e paditura e ka kontestuar bazën ligjore të kërkesëpadisë dhe është thirrur në parashkrim të kërkesës, gjykata ka vlerësuar se në këtë çështje nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor sepse, themelësia e kërkesëpadisë bazën ligjore e ka në dispozitat e nenit 55, par. 1 të Ligjit të Punës, i cili ka përcaktuar se: “I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenit 90, par. 5 i cili ka përcaktuar se: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive” dhe Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021; nenin 35, par. 10 sipas të cilit është përcaktuar: “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”. Dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit e V.t 2017 aplikohen edhe për periudhën Janar 2019-20.01.2021, ndërsa pas kësaj date ato të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë nr.01B/2056 dhe për V.n 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021-21.11.2022.

Gjykata, pasi gjeti se paditësi e cila është e punësuar tek e paditura nuk është kompensuar për shkallën e inflacionit sipas përqindjes së përcaktuar nga Enti i Statistikave të Kosovës, ndërsa ky kompensim arrin shumat e aprovuara, të cilat janë të llogaritura në bazë të përqindjes për V.n përkatës dhe periudhës kohore të kërkuar për këto vite, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata refuzoi pjesërisht kërkesëpadinë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimit pasi që kërkesa për pagesën e shumës së kërkuar për periudhën janar-dhjetor 2018, janar-dhjetor 2019, janar-dhjetor 2020 dhe muaji janar i V.t 2021 është parashkruar, kjo sepse paditësi ka ushtruar padi me datë 29.01.2024 ndërsa, duke llogaritur 3 vite mbrapa nga data e ushtrimit të padisë (janar 2024-janar 2021), del se kërkesa e paditësit për kompensim për periudhën e lartcekur, është e parashkruar (neni 87 i Ligjit të Punës).

Kundërshtimet e të paditurës janë gjetur të pa bazuara sepse palët kontraktuese të KKAK-së, (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), në nenin 2, par. 1.2., kanë përcaktuar: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat-DKA, etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës” andaj, gjykata aprovoi të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Sa i përket pretendimeve se nuk

ka pasë inflacion të theksuar, sipas nenit 35 të Kontratës mjafton vetëm konstatimi se ka pasur inflacion.

Vendimi për kamatën është bazuar në nenin 382 të LMD-së ndërsa, për shpenzimet e procedurës në nenin 452.1 lidhur me procedurat e kontesteve me vlerë të vogël, të përcaktuar në nenin 485.1 të LPK-së dhe numrin tarifor 6 nga Tarifa e Avokatëve të Kosovës, ashtu që gjykata ia ka pranuar shpenzimet paditësit në shumën 78 € për përpilimin e padisë dhe 21 € për taksën gjyqësore për padi, në shumë të përgjithshme 99 €.

Nga të lartcekurat, e duke u mbështetur edhe në nenin 142 dhe 398 e 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V.

C.nr.718/2024, Datë 22.03.2024

Gjyqtari,
Alush Sinani

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit. Ankesa në kopje të mjaftueshme, dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.